



ENTI BOTUES



Poradeci

tel: +355 83 222 905

E përmuajshme informative

Nr. 489 Prill 2012

Çmimi 20 Lekë

Bota Lasgushiane, Atdheu, Dashuria, Natyra



Lexoni në faqen 13

Suplement nga
Grupi Monitorues i
Këshillit Bashkiak

Angazhohu
Monitoro
Vepra



Lexoni në faqen 5-12

U shpallën fituesit e konkursit me titull "Nga paqja në shtëpi, tek paqja në botë!" Fituesit marrin si shpërblim:

1 set librash, certificate, si dhe në vlerë monetare.

Emrat e fituesëve në ese janë:

1. Olma Karoli- Pogradec
2. Greta Bakollari- Mëmëlisht
3. Dhimitraq Ngjela- Korçë
4. Andiola Dumbo- Rëmenj
5. Klaudja Mertkola- Rodokal
6. Jona Hoxhaj- Pogradec

Në Pikturë:

1. Polikseni Shuta - Pogradec
2. Manol Karaj- Pogradec
3. Elda Pere, Sara Bejlliu - Tushemisht
4. Evri Konopulli- Pogradec

Faleminderojmë për bashkëpunimin të gjithë pjesëmarrësit në këtë Konkurs.

Shoqata Unë, Gruaja
Pogradec

Dita Botërore e Librit



23 Prill 2012

**Libri ndriçon mendjen,
MENDJA
ndryshon
BOTËN!**



Shoqata "Unë, Gruaja" Pogradec



Kultura e popullit tonë ka një themel monumental ngaqë ka gjuhë të njësuar

I quaj kësisoj (përsiatjet) ngaqë më vijnë si ca mesazhe telegrafike - mors, nga kahje të ndryshme, por që, gjithsesi, pikëtakimin e kanë të njëjtë: shqetësimin qytetar. Ky i fundit fillimin e ka në domosdonë e mënjanimit të parashtrimit të mendimeve që nuk ngjallin interes. Të tilla do të ishin çështjet a problemet, të cilat i njohin të gjithë apo janë të informuar në mënyra, mjete e rrugë të ndryshme. Në rastin më pak të keq, lipset që ajo që hedh në letër të ketë një farë karakteri sensacional në kuptimin që të zgjojë dhe ta ushqejë kërkshërinë e lexuesit. Kjo vlen edhe për televizionin, ku flitet pa kufi. Për më tepër vihet re një etje e pashtershme për të dalë në ekran. Shkrimtarët më kot përpiqen të bëjnë emër përmes rritjes së numurit të librave dhe të tirazhit të tyre. Mjaft të shfaqen një herë në ekran dhe kanë për të marrë shumë herë më shumë urime të drejtpërdrejta apo me telefon, se sa për të gjitha botimet bashkë. “Zotëri, të pashë *mbrëmë në televizor!*” Rrallëherë gjendet ndonjëri që t’i thotë: “*Ta lexova librin*”.

Diçka tjetër. Ne bëjmë çmos që të lëvizim sa më pak që të jetë e mundur. Dëshirojmë ta tkurim përpyjekjen njerëzore. Të paktën pas kthesës së fillimviteve '90 të shekullit të kaluar shpresonim që njerëzit do të eteshin më shumë drejt leximit, drejt edukimit. Por, duke përdorur me tepri, njëlloj si edhe më parë, në vazhdimësi, shpikjen e jashtëzakonshme që quhet televizion, shumëkush orvatet që, mundësisht, të mos bëjë kurrjë, por thjesht të riprodhojë ide të gatshme, të përgatitura më parë, nga të tjerët. Janë gjithnjë e më të shumtë ata që nuk pranojnë të punojnë me trurin, i cili, fatmirësisht, tanimë ka shanse të plota të mendojë, të veprojë dhe të shprehet lirisht. Njeriu i shekullit të parë të mijëvjetshit të tretë nuk duhet të jetë kursesi partizan i dogmave,

Përsiatje me “hallakatje”

Shkruar nga KOPI KYÇYKU

Fantazia, thellësia psikologjike, fuqia e intuitës dhe e aspiratave, janë cilësi, rrënjët e të cilave janë mbjellë në vetëdijën e një populli të tërë.

të cilat, në fund të fundit, janë një formulë e iracionales. Kjo e fundit, duam s’duam, ekziston, por duhet synuar t’ia ngushtojmë paprerë hapësirën e veprimit.

Rrezikshmëria e të menduarit dhe sidomos e të vepruarit në mënyrë dogmatike, në emër të një ideologjie apo të një tjetre, - paçka se këto nuk para zihen më në gojë, - mishërohet edhe në orientimin e vetëdijës njerëzore drejt prodhimit, përkryerjes dhe përdorimit të armëve të shkatërrimit në masë. Këtu kam parasysh jo vetëm bombat e plumbat, por edhe “sëmundjet” shpirtërore që përhapen me mjetet e komunikimit masiv e që çënojnë ndjenjat e karakterin e njeriut. Pikërisht kundër një orientimi të tillë ekskluzivist duhet të ngrihet mendimi racional i njeriut, me synim ndërthurjen e përparimit teknik pozitiv me shëndoshjen shpirtërore. Sepse jeta njerëzore, në kuptimin e plotë të fjalës, është vetëm ajo që zhvillohet në rrafsh shpirtëror. Dhe këtë e mundësojnë idetë. Nga ana tjetër, sado risi-sjellëse qoftë një ide dhe sado me vërtetësi e besnikëri ta pasqyrojë realitetin ekzistues në periudhën përkatëse, nuk mund të kthehet kursesi në një ide - forcë përveçse në kushte historike të caktuara, në radhë të parë social - politike.

Përvoja shumëshekullore na tregon se shumë prej ideve madhore që ka konceptuar njerëzimi, u është dashur të presin një kohë të gjatë për të dëshmuar

efektin e tyre ngaqë nuk përputheshin me situatat përkatëse. Në këtë kontekst, vlen të theksojmë se, lidhur me origjinalitetin dhe risinë e ideve, edhe atëhere kur përpiqemi të bëjmë diçka, të sjellim diçka të re, nocioni i së resë jo rrallë përdoret tjetër për tjetër, përderisa nuk përcaktohet thelbi, përmbajtja, misioni i saj konkret. Sepse jo gjithçka e re është medoemos edhe e mirë, e dobishme. Risia në vetvete ende nuk përbën vlerë, përveçse kur gjen mishërim dhe parakushte për t’u zbatuar. Pra, ndonjë ide filozofike abstrakte, pa “jehonë” në praktikë, tingëllon si teorizim në hava, në teori për teori.

Dihet, bie fjala, që grekët e lashtë huazuan ide të panumurta nga Orienti, gjë që nuk e kanë mohuar kurrë. Madje, megjithse duket e pabesueshme, mburreshin me çka kishin përvehtësuar prej asaj zone të globit.

Me rëndësi të posaçme këtu është të theksojmë faktin që “huazimet” e lartpërmendura kishin në themel dobini praktike, shkencore dhe teknike. Orienti mund të ishte edhe “eksportues” i madh mitologjish, por grekët parapëlqyen të merrnin me të dyja duart jo mitet, por idetë praktike. Është rasti këtu të admirojmë instinktin helen, që i detyrohet mprehtësisë intelektuale në përzgjedhjen e asaj që hynte më shumë në punë. Gjithçka qartësohet po të mbajmë parasysh se bëhej fjalë për një shtresë

shoqërore, pjesë organike e skllavopronarëve, e përbërë nga tregtarët, pronarët e anijeve dhe të prodhimeve të zejtarisë, që nuk i lidhte asgjë me mitet orientale. Ata e kishin të qartë se prodhimi nuk bëhej me mite, por me ide shkencore, që kishin rrjedhoja të drejtpërdrejta praktike.

Në art efektet janë konkrete në kuptimin që duhet të prekin e t’i bëjnë të tingëllojnë telat e zemrave e të shpirtrave të konsumatorëve të tij. Ushqimi moral i artit është ndodhur në hapësira, të cilat e kanë kapërcyer estetikën e mirëfilltë, pikërisht në sferën gjithëpërfshirëse të njerëzores. Vetëm një pjesë e energjisë së shpirtit krijues gjen mishërim në botën e fjalëve, tjetra kërkon “fytyrë” në jetë. Fantazia, thellësia psikologjike, fuqia e intuitës dhe e aspiratave, janë cilësi, rrënjët e të cilave janë mbjellë në vetëdijën e një populli të tërë. Në këtë mbulesë të artë të ekzistencës, në përfytyrimin krejt-rrokës të një kombi, e ka tharmin ndjeshmëria e simbolit poetik, ngarkesa njerëzore, pesha e frytit që ka arritur në fazën e pjekjes së metaforës lirike. Poeti i sotëm, si çdo njeri që konsolidon “direkun” e shtëpisë së vet, që shkruan një vjershë, apo ai që thjesht rrefen një përrallë apo një proverbë, hyn në gjendje komunikimi me vullnetin e mbarë kombit, me kohën dhe hapësirën e vulës së vet origjinale. Kemi të bëjmë me një dialog të shënjtë, në të cilin lëvozhga e fjalëve dhe thelbi i nxehtë i domethëniesve kërkohen e thithen ndërsjelltas.

E kushtëzuar nga ekzistenca fenomenale, nga përkatësia jonë në kulturën që na e ka ngjizur personalitetin artistik dhe moral, letërsia jonë duhet të mbështetet në besimin në përjetësinë e kombit dhe në karakterin e mirëdallueshëm të tij. Realiteti “i angazhuar” i procesit demokratik - konstruktiv në vendin tonë duhet

Deklaratë

Libri ndriçon mendjen, mendja ndryshon botën!

Është i katërti vit që shoqata “Unë, Gruaja” organizon veprimtari me rastin e Ditës Botërore të Librit, si homazh për librin dhe autorët, si ftesë për të rinjtë që të pasurojnë bibliotekat e tyre.

Sivjet do të diskutojmë së bashku: “Dhurata më e çmuar është pasioni për të lexuar”. Në këtë ditë le të përcjellim tek të rinjtë dashurinë për librin, duke i ftuar ta mbajnë gjithmonë pranë. Një libër më tepër në bibliotekën e shtëpisë është një hap më lart në shkallën e dijes.

Një kohëzgjatë e rastit ka bashkuar më 23 prill disa ngjarje të rëndësishme, që lidhen me jetën e shkrimtarëve të shquar. Më 23 prill 1616 u ndanë nga jeta Servantesi, Shekspiri etj. Për këtë arsye 23 prilli është caktuar nga UNESCO Dita Botërore e Librit.


Një kohëzgjatë e rastit bashkon emrat e këtyre shkrimtarëve, por nuk është rastësi nderimi dhe respekti për librin. Në këtë datë meditojmë për lidhjet tona të shumta e të pazgjydhshme me librin.

“Kam pasur në jetë vetëm një mik të vërtetë dhe të sinqertë, librin!” -ka thënë Volteri.

Një mik që na qëndron gjithmonë në krah dhe na këshillon në rrugën e jetës. Një mik që përcjell mesazhe, duke kapërcyer kufijtë e kohës dhe hapësirës. Që në hapat e para të jetës shumëkush ka buzëqeshur para faqeve të një libri, është rritur bashkë me të; ai e shoqëron besnikërisht njeriun deri në vitet e pleqërisë së vonë.

Libri me dijet dhe emocionet që na përcjell, është prehje për të lodhurit, ngushëllim për të brengosurit, shpresë për të pashpresët, gëzim për të gjithë. Një mik i vërtetë dhe i sinqertë që edhe kur e nënvleftëson dhe e harron përkohësisht, pret me durim që t’i rikthehesh. E gjen kudo këtë mesazher të dijes dhe kulturës, me mesazhe që përcillen nga populli në popull, nga shekulli në shekull. Duke kapërcyer barrierat që na ndajnë, libri na bashkon të gjithë brenda atij lloji që quhet njerëzim. A mund të ketë një mik tjetër dhe mësues të sinqertë, si libri, që i qëndron pranë fëmijës dhe të moshuarit, nxënësit të shkollës dhe filozofit?!

Pa librin bota do të ishte krejt ndryshe, një botë mece dhe e verbër, në kuptimin intelektual ai e bëri njeriun njeri, e zbriti në tokë, e lartësoi moralisht, e fisnikëroi dhe e bëri atë qenien më të ditur dhe më të kultivuar mbi dhe. Nga të gjitha pasuritë e kësaj bote, libri është thesari më i çmuar, një thesar që rritet e shtohet duke pushtuar botën me dije, kulturë, ide dhe informacione. Duke menduar këtë, kuptojmë se ç’pasuri të paçmuar kemi në duar, ndaj e meriton t’i ngrihet një përmendore librit më 23 prill. E meriton ta ketë një ditë të shënuar, kur duhet t’i kushtohemi, t’i rikthehemi dashurisë së parë, librit, për ta pasur pranë në çdo ditë të vitit.



Prandaj motoja e sivjetshme për ne është:

Libri ndriçon mendjen, mendja ndryshon botën!

Shoqata “Unë, Gruaja”, prill 2012

Përsiatje me “hallakatje”

Vijon nga faqja 2

të na nxitë të kuptojmë përsëthelli kohën në të cilën jetojmë dhe sidomos detyrat që kemi përpara. Gjithçka kalon përmes nesh - prej realitetit drejt e në shpirt. Të përsiatësh rreth librave të ardhshme, rreth perspektivës që do të ketë letërsia në kohë, do të thotë të zbulosh vlerat përtej fjalëve, vlerat e disa aspiratave dhe idealeve demokratike të popullit tonë.

Letërsia është një terren heterogjen. Ndikimi i të gjitha disiplinave të tjera të shpirtit njerëzor mbi letërsinë është i dukshëm dhe, në këtë drejtim, filozofia ia del mbanë të lerë gjurmë të thella mbi letërsinë. Por, vërehen edhe ndryshime: koncepti metaforik, koncepti poetik është i ndjeshëm, “i kapshëm” nga shqisat e sidomos nga zemra, ndërsa ai filozofik është

kryekëput abstrakt dhe ka tjetër strukturë, të një lloji tjetër të veprimtarisë njerëzore. Filozofi mund të jetë poet me raste, edhe poeti, gjithashtu, mund të jetë filozof, pò me raste. Kur poeti shkruan një poezi filozofike, ai është në radhë të parë poet, pastaj edhe filozof.

Kultura e popullit tonë ka një themel monumental ngaqë ka gjuhë të njësuar dhe vetëm uniteti i popullit mund të quhet monumental. Ky lidhet me unitetin e mendimit, të ndjenjave dhe të mënyrës se si e paraqit veten, si i shpalos vlerat para botës. Përfshi këtu prodhimet artistike, këngët, kostumet, të cilat janë ose identike ose tejet të përafërta në të gjitha krahinat. Edhe në to fryn filladi i unitetit shpirtëror e gjuhësor të kombit mbarë. Larmia gjeografike nuk e çënoi unitetin e ndjenjave, të të menduarit dhe të të vepruarit të popullit tonë.

Meqë përmendëm termin “monumental”, le të merremi pak me vetë monumentin si të tillë. Ky përfaqëson një akt politik, në rrafsh historik, një unitet mendimi, qoftë kur paraqit një personazh apo një bëmë historike. Ai mbetet si një entitet, si një ngrehinë publike, një lloj si një pallat, si një katedrale. Nuk duhet ngatërruar monumentalja me kolosalen. Monumental mund të jetë edhe një dru dekorativ shumëshekullor, por jo edhe një grataçiel pa pretendime artistike.

Në rastin tonë, monumentalja parakupton madhësinë. E këtë fjalë kemi të drejtë ta përdorim me krenari përderisa në të gjitha kohërat, në pajtim me detyrat - misione, që i ka caktuar vetes, kombi ynë mbetet shëmbëlltyrë e një monumenti të gjallë e të amëshuar. Të tillë duhet ta këqyrin shkrimtarët e artistët, shkencëtarët e politikanët. Dhe kjo, para së gjithash, do t’i ndihmojë ata vetë, që të krijojnë vepra të denja për t’u çmuar, sot e në të ardhmen.

“ECURIA E NEGOCIATAVE DHE MARSHI I GLOBALIZIMIT TË SOTËM”

NEGOCIATAT DHE GLOBALIZIMI

(me autorë Prof. Shpëtim Cami dhe Ass. Dorian Leka)

“Negociatat Dhe Globalizimi” i përket natyrës studimore në shërbim të studentëve, profesorëve dhe katedrave universitare, kryesisht për Departamentet e Shkencave Politike, por edhe ato Juridike dhe Ekonomike.

Libri është sendërtuar mbi njohuritë bazë mbi lëndën Negociatat dhe Globalizimi, ndaj edhe struktura e tij vjen e fragmentarizuar në dy shtylla, fillimisht trajton Negociatat dhe më pas vijon në pjesën e dytë me Globalizimin. Prania e slide-ve prezantuese gjatë leksioneve dhe skemave të seminareve, përfshi këtu pyetjet orientuese dhe temave inspiruese për reflektim eseistik mbi materialin e servirur, e sjellin këtë literaturë sa më pranë studentëve si ‘informacioni i rëndësishëm në kodet më të thjeshta’ duke qënë kështu edhe në shërbim të kujtdo që interesohet mbi ecurinë aktuale të Negociatave (si në praktikë, ashtu edhe në këndvështrimin teorik), marshit të Globalizimit të sotëm (sfidat e pranimit dhe frikërat ndaj tij).

Siç do të shprehet në pjesën hyrëse të këtij libri edhe profesor Shpëtim Cami (kandidat për PhD), bartës i lëndëve në të cilat asistojë, por në këtë rast në cilësinë e njërit prej autorëve: *“Negocimi është një proces që fillon nga familja, në shoqëri, punë të përditshme, biznes, gjykata, arsim dhe kudo ku bëhen dy apo më shumë persona që kanë interesa reciproke. Ndërkohë negociimi është baza e marrëveshjeve ndërkombëtare midis shteteve, organizatave ndërkombëtare dhe qeveritare, organizatave joqeveritare dhe individëve të veçantë. Në këtë kuptim, bazat e ‘Artit të Negociatave’ do të ishte mirë të studioheshin sa më herët që të jetë e mundur. Aq më shumë për ne ballkanasit, për të shmangur sadopak konfliktet historike, apo ato të viteve të fundit. Ndërkohë, Globalizimi është një proces dhe fenomen që është familjarizuar me të gjithë, ndoshta jo si emërtim apo koncept, por si një veprimtari e përditshme, duke dëgjuar lajmet nga bota dhe rajoni, duke lexuar gazetatat, duke punuar në internet, duke konsumuar mallra, ushqime, shërbime dhe arsim nga Evropa, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kina, qoftë edhe nga Brazili, Afrika apo Kanadaja”.*

Natyrisht, meqenëse operojmë të lokalizuar në pellgun ballkanik, këtij të fundit do t’i kushtohet një rëndësi më e madhe gjatë trajtimit të moduleve, si përshembull: Negociatat Shqipëri – Greqi mbi problemin e kufijve detarë; Marrëdhëniet Maqedoni – Greqi me problem negociues: emrin e Maqedonisë; Negociatat Kosovë – Serbi mbi njohjen e pavarësisë së Kosovës, etj. Ndërsa në pjesën e Globalizimit përmendim: Globalizimi në këndvështrimin e një studiuesi shqiptar; Përfitimet nga Globalizimi dhe frikërat ndaj tij; Çështjet Globalizuese me problematikë shëndetësore, mjedisore dhe të drejtave të njeriut; Universitetet si çështje globale, etj.

Por nuk përjashtohen edhe rastet e analizës dhe hulumtimit të ngjarjeve ndërkombëtare, si të pandara dhe integrale me fenomenet e hershme retrospektive. Renditen si jo më pak të rëndësishme edhe zhvillimet e sotme globale me domosdoshmërinë e reagimit të menjëhershëm të aktorëve kombëtarë dhe ata të arenës ndërkombëtare, me dështime dhe pasoja nga njëra anë, apo me përfitime dhe negociata nga ana tjetër. Gjatë pjesës së Negociatave përmendim: Trajtimi i modeleve të ndryshme negociatorësh, si Uniston Çerçill (Winston Churchill); Teori, strategji dhe taktika negociuese sipas shteteve; Krahasimi i negociatave sipas tipit dhe llojit; Diferenca ndërmjet stileve negociuese (stile profesionale, gjinore dhe individuale); Etika dhe përdorimi i forcës, etj. Ndërsa gjatë pjesës së Globalizimit: Tendencat globale dhe profilet e globalizimit; Aktorët e politikës ndërkombëtare dhe ndikimi i tyre; Reagimi i shteteve dhe qëndrimi i përfaqësuesve të rrymave të ndryshme; Gjeneratat e të drejtave të njeriut; Zëri dhe Globalizimi (diskutime, reflektime, hipoteza dhe teori), etj.

Studentët e degës Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci në Departamentin e Shkencave Politike të Universitetit Ndërkombëtar të Strugës, kanë dhënë kontribut të paçmueshëm me frekuentimin e tyre dhe punën aktive (personale apo në grup) duke paraqitur informacione të dobishme në trajtën e eseve, detyrave të kursit apo projekteve shkencore, opinione dhe analiza, të cilat na ndihmuan së tepërmi gjatë përpilimit të librit tonë.

Sot jemi të vetëdijshëm për një dyndje masive në tregun e botimeve (duke përgëzuar ato të profilit universitar), por duke qënë në dijeni të literaturave të pamjaftueshme mësimore në shërbim të lëndëve Negociatat dhe Globalizimi, si lëndë të reja nëpër universitetet e rajonit dhe më gjerë, tentuam të kryejmë një pasqyrë sa më të pasur dhe reale të metodës sonë të operimit gjatë mësimdhënies.

Duke përfshirë në këtë botim jo vetëm reflektimet tona shkencore, por edhe një pjesë nga literatura e larmishme që zotëronim (me autorë amerikanë, anglezë, evropianë, indianë, etj). Në këtë mënyrë ky libër krijon hapësira për të gjithë ata që duan t’i ndjekin këto fusha studimi në funksion të progresit të tyre shkencor, qoftë edhe akademik.

Libri gjendet në disa prej librarive kryesore të vendit. Në faqet përmbyllëse autorët kanë publikuar kontaktet e nevojshme për çdo sugjerim apo këshillë nga ana e lexuesit.


Dorian Leka



UNIVERSITETI NDËRKOMBËTAR I STRUGËS

Lektor Shpëtim Cami Ass. Dorian Leka

NEGOCIATAT &
GLOBALIZIMI



STRUGË 2011

Angazhohu Monitoro Vepru



SUPLEMENT NGA GRUPI MONITORUES I KËSHILLIT BASHKIAK,
POGRADEC, PRILL 2012

*Dioptritë e ndryshme të lupës së monitoruesve mbi
mbledhjet e Këshillit Bashkiak, Pogradec*



KARTONAT E VENDIMMARRJES	faqe 2
BESIMI QYTETAR I ZGJEDHËSVE NDAJ TË ZGJEDHURVE	faqe 2
MANDATET: TË KUFIZOHEN APO JO?	faqe 3
ZGJIMI I ZHURMSHMËM I KËSHILLIT BASHKIAK	faqe 3
INTERVISTË ME DREJTORIN E NDËRMARRJES SH.A. UK, Z. ILIR MIMINI	faqe 4

EDITORIAL

Ky buletin vjen si produkt i monitorimit vullnetar të një grupi të rinjsh pogradecarë me përbërje të larmishme gjinie, moshe dhe pozicioni profesional. Ndër ne, radhiten studentë të arsimit të lartë me profil studimi: Shkencat Sociale, Ekonomike, Juridike dhe Politike.

Nën koordinimin e Shoqatës “Unë, Gruaja”, bujarinë e shtëpisë botuese “D.I.J.A - Poradeci” dhe gazetës “Nositi” të gjitha opinionet që rrjedhin nga monitorimi ynë, do të botohen në këtë buletin, i cili do të vijë në duart e qytetarëve papagesë.

Qëllimi i këtij monitorimi, vjen si zbatim i politikave orientuese dhe udhëzuese evropiane mbi përmirësimin e procesit të vendimmarrjes lokale, por edhe si plotësimi i një detyre të rëndësishme qytetare, detyrë e cila nuk nënkupton vetëm rehatimin në një nga ulëset e Këshillit Bashkiak, por dhënien e opinioneve dhe sugjerimeve, kur vlerësohet se një dioptri ndryshe nga të pranishmet, do të rivendosë një të drejtë qytetare prag nëpërkëmbjes.

Natyrisht, secili mendim (nën limitet e modestisë) i pasqyruar nga ana e

monitoruesve, është i hapur për diskutim publik mediatik, duke i dhënë mundësi kujtdo të interesuari të replikojë opinionet që shpalosen në këtë buletin.

Diskutimi dhe debati i drejtë është katalizatori kryesor për realizimin e pritshmërive në dobi të qytetit tonë dhe banorëve të tij, kjo nuk është vetëm motoja e këtij monitorimi, por edhe domosdoshmëri për aplikim në çdo arenë, ku i vendos rregullat zgjedhësi i të zgjedhurve.

Kryeredaktor DORIAN LEKA

KARTONAT E VENDIMMARRJES

DORIAN LEKA

Mbledhja e këshillit bashkiak filloi në orën 10:13 të datës 07. 02. 2012, ashtu siç ishte parashikuar vetëm pak ditë më parë. Qysh në momentet e para ndihej atmosfera e zhurmshme e një mbledhjeje, por kësaj here të mbikqyrura nga mediat lokale (Sot7) dhe nga grupi ynë i monitorimit, i cili ishte shpërndarë në sallë për t'u informuar paraprakisht mbi hipotezat e mundshme të diskutimit, pak para fillimit të mbledhjes. Me ardhjen e kryetarit të bashkisë, z. Artan Shkëmbi, pas përshëndetjeve, u homogjenizua situata kakofonike me një qetësi rreshtoreje ushtarake. Aty mund të konstatohej lehtë mungesa e katër këshilltarëve, ndërkohë që kishte pesë nëpunës së administratës bashkiake dhe asnjë qytetar të interesuar.

Thua asnjë pogradecari nuk i intereson se ç'gatuhet në mbledhjet e këshillit bashkiak?

Tema si, buxheti dhe shpërndarja e investimeve, ndihma ekonomike, të pastrehët, etj, janë promotori i mijëra debateve të ashpra që nisin nga familja dhe klimaksohen nëpër kafenetë e qytetit, por që askush prej tyre (madje edhe kur i cënohen interesat) nuk denjon të marrë pjesë në mbledhjet e këshillit.

Miratohet rendi i ditës dhe pas një skene të përshpejtuar votimi, ku mund të vëreje edhe kartonë të ngritur që nuk uleshin pavarësisht ndryshimit të temave të axhendës, apo nga ata që e mbanin kartoni në gjysmështizë se nuk gjenin detyrat e shtëpisë, të bëra apo dhëna nga dikush tjetër, për të votuar sipas një rendi

të planifikuar... diku u thye rutina. Një këshilltar ngriti pretendimin se fondi i përcaktuar për futbollin ishte i tepërt dhe kjo diferencë duhej t'i kalonte ngrohjes së shkollave, kur jo pak më parë ishte lajmëruar mbyllja e tyre (tendencioze) sipas këshilltarit Nardi Berberi. Të njëjtin arsyetim mbi fondin e futbollit ndoqi edhe këshilltarja Alketa Darova, duke thënë



se shpenzimet e sportit janë të pakontrolluara.

Kryetari i bashkisë pasi shfletoi haptazi nga poltroni disa procesverbale të mbifurnizimit me naftë të shkollave nga ana e bashkisë, gjegjësisht 1200/l nga 400/l të planifikuara, propozoi të shkonin në atë çast diskutimi për të mbikqyrur pajisjen me lëndë djegëse të shkollave. Nëse do të rezultonte mungesa e tyre, atëherë u zotua të japë dorëheqjen e menjëheshme dhe e anasjellta për këshilltarët në fjalë. Ndërkohë që kryetari replikoi pretendimin e ngritur edhe nga këshilltarja Darova, pasi shpenzimet e Klubit të Futbollit janë objekt i Inspektoriatit të Tatimeve, si Sh.A.

Debati u shtri edhe në radhët e tjera të këshilltarëve, të cilët dhanë një propozim shumë të rëndësishëm: "Le të bëhemi një grup monitoruesish me përbërje këshilltarësh dhe të kontrollojmë sipas orëve sesa shpenzon kaldaja dhe nëse konstatojmë abuzim të energjisë, karburant të përvetësuar apo padrejtësi të tjera, t'i denoncojmë dhe të ndiqen penalisht" – u shpreh Abdullah Cane. Propozimi i z. Cane nuk gjeti përkrahësit e mjaftueshëm, për të mos folur për pashirrat refuzuese të disa këshilltarëve të tjerë, të cilët çështja e ngrohjes së fëmijëve nuk iu ngrinte asnjë dallgë në ndërgjegjen e tyre. Pasi u gjykua se kjo temë po tejzgjatej dhe shumë të pranishëm tundnin kartonat për t'u rikthyer sa më parë në punën e tyre të përditshme, diskutimi u mbyll.

Vijoi votimi i temave të tjera, në të njëjtën skemë që lartpërmendëm, derisa të gjithë u larguan (për ironi të fatit) në të njëjtën kohë kur edhe nxënësit sapo ishin liruar nga mësimi për shkak të temperaturave të ulëta. Natyrisht, konstatimet tona janë të shumta si për nivelin e informimit të këshilltarëve, moralin e dyshimtë të votimit dhe diskutimit, procesverbalet e bashkisë dhe abuzimet e mundshme të shkollave mbi furnizimin me naftë, por këto janë vakume të cilat nëse qytetarët, mediat lokale, grupe të ndryshme monitoruese, do të vijojnë me mjete kontrolli, atëherë do të ndërgjegjësohen të gjithë aktorët e vendimarrjes lokale, për të qenë sa më pranë nevojave të qytetarëve dhe qytetit tonë.

"Ndoshta nuk iu ofruam përgjigjet e pritura, por besojmë se ngritëm pyetjet e duhura."



Besimi qytetar i zgjedhësve ndaj të zgjedhurve

LEDJAN ZEQQOLLARI

Mbledhja e Këshillit Bashkiak, e mbajtur më 06 . 03 .2012, kryesisht kaloi duke mos prishur formalitetin e institucionit të rëndësishëm vendimmarrës të qytetit. Gjatë zhvillimit të mbledhjes u vu re një mungesë e vogël e anëtarëve të Këshillit. Kjo mbledhje “u monitorua” vizualisht nga “TV SOT 7” duke krijuar tek këshilltarët “frikën” e kamerës televizive. Nisja dhe vazhdimi i procesit të votimit kaloi normalisht, duke votuar sipas radhës së përcaktuar të gjitha projekt-vendimet. Në shumicën e rasteve u duk sikur anëtarët kanë rënë “dakort” për çështje të ngritur për votim.

Gjatë procesit të monitorimit vihet re se disa nga anëtarët nuk ishin pajisur me materialin e kërkesave të mbërritura nga qytetarët. Kjo solli dhe mosmiratimin e këtyre kërkesave, si pasojë e mosdiskutimit paraprak të materialit në Komisionet e Këshillit. Sipas disa anëtarëve nuk mund të votohej kjo pikë e rendit të ditës pa u njohur të gjithë me materialin e munguar, gjë që solli edhe një debat të vogël, i cili prishi rutinën e heshtjes.

Në këto mbledhje u vu re një diskutim thjesht formal i çështjeve që shtrohen për diskutim. Vetëm rreth dy ose tre prej këshilltarëve diskutojnë, të tjerët parapëlqejnë heshtjen duke mos dashur të dalin nga korniza e përfaqësisë së tyre politike. Aktivizimi i tyre i vetëm dhe përfundimtar është ulja dhe ngritja e kartonit “Pro” ose “Kundër”. Shumica e

projekt- vendimeve u miratua me shumicë votash “Pro” edhe pse kishte kundërshtime apo diskutime të ndryshme. Gjatë gjithë miratimit të projekt -vendimeve, vetëm një këshilltar votoi kundër për dy nga çështjet e rendit të ditës.

Ajo që të bën përshtypje gjatë gjithë kohës është pjesëmarrja e pakët ose e aspakët e qytetarëve në këtë mbledhje. Përjashtim në këtë mbledhje ishte prania e një personi të interesuar



për miratimin e listës emërore të qytetarëve të pastrehë, që kanë aplikuar për kredi me kushte lehtësuese. Edhe pse mbledhjet e Këshillit janë të hapura për çdo qytetar ato vazhdojnë të jenë “të varfra” nga pjesëmarrja e shoqërisë civile. Duke ditur që ky institucion është shumë i rëndësishëm dhe lidhet direkt me përmirësimin e kushteve të jetës së qytetarëve.

Së fundi, ashtu si të zgjedhurit dhe ne zgjedhësit jetojmë në një mjedis të përbashkët ku përgjegjësitë dhe detyrat i kemi pothuajse të njëjta. Por të zgjedhurit kanë marrë atë që quhet “besim” qytetar. Prandaj, punë e mirë e tyre vjen si rezultat i përgjegjësisë së tyre dhe përgjegjësinë e tyre ata duhet ta dëgjojnë nga fjala e shoqërisë civile.

Grupi Monitorues i Këshillit të Bashkisë

1. Dorian Leka
2. Ligerta Karaj
3. Ledjan Zeqollari
4. Mariglen Vreto
5. Leonida Karaj
6. Marsela Çuli
7. Genti Çela
8. Denada Mani
9. Xhensila Topçiu
10. Alban Gusho
11. Besmira Isallari



Mandatet: të kufizohen apo jo?

NGA ILIR BUZALI

Kohët e fundit po diskutohet gjerësisht lidhur me kufizimin e mandateve tek politikanët dhe të zgjedhurit. Ka dy qëndrime të kundërta. Njëra palë, që kërkon kufizimin e mandateve, e argumenton këtë me faktin se ai që vjen në pushtet, “e privatizon” pushtetin, duke e shfrytëzuar për t’u rizgjedhur disa herë me radhë, aq sa është e vështirë të ketë konkurrencë. Pala tjetër argumenton se nuk ka pse të kufizohet drejta për t’u zgjedhur, përderisa i zgjedhuri punon mirë dhe e meriton këtë. Sjellin edhe fakte nga eksperiencia botërore kur kryetarë bashkie të qyteteve të rëndësishme janë në atë post prej dhjetra vitesh.

Në fillim duhet të sqarojmë se e drejta për t’u zgjedhur është një e drejtë kushtetuese dhe një nga të drejtat themelore të njeriut në demokraci. Për të kufizuar dikë nga kjo e drejtë, duhet të ketë arsye shumë të forta. Po përqëndrohemi tek të zgjedhurit lokalë. Në një analizë të parë, si pala pro kufizimit dhe pala kundër kanë të drejtë. Praktika jonë ka treguar se kryetarët e bashkisë, pasi fitojnë në zgjedhje e shfrytëzojnë postin në funksion të mandatit të ardhshëm, nuk dinë ose më mirë të themi nuk duan të lënë hapësirë për kandidatët e tjerë.

“Modeli shqiptar” tregon që mandati i parë në rastin më të mirë, është i suksesshëm, më tej konsumimi bën punën e vet, bie interesi i të zgjedhurit për ndryshime, s’ka ide të reja, fillon monotonia. Pak nga pak ata të kujtojnë figurën e “kolltukofagut” të Fan Nolit, zyrtarit shqiptar të

asaj kohe: ai i ngjan luftëtarit grek në luftën detare greko-persiane; ai e kapi lundrën e armikut me dorën e djathtë, por pesianët ia prenë; e kapi me të majtën, ia prenë. Atëherë e kapi me dhëmbë e s’e lëshonte. Vetëm pasi i prenë kokën, u shkëputën prej tij.

Historia e zyrtarëve të kohës së Nolit, përsëritet. Kolltukofagët tanë kapen me thonj e me dhëmbë pas karriges së pushtetit dhe është e kotë të presësh të shkëputen me vullnetin e tyre. Kështu pas mandatit të parë, mandatet e tjera s’përbëjnë ndonjë çudi. Por ka dhe diçka që s’duhet lënë pa u përmendur: të zgjedhurit lokalë, kryetarët e bashkive, por edhe këshilltarët, shpesh në fillim të mandatit janë nëpunës modestë, kurse në mbarim të mandatit shfaqen si biznesmenë të suksesshëm. Sa më shumë të përsëritet mandati, aq më të konsoliduara i kanë bizneset. Për këtë bindesh më tepër, kur kujton prirjen e biznesmenëve vitet e fundit për t’u bërë këshilltarë lokalë.

Nën shembullin e të zgjedhurve, edhe administrata lokale nuk lë kusur, e shfrytëzon vendin e punës për përfitime private. Pra përmbledhtas duhet të themi që një mandat është pak, dy mandate janë shumë.

Përsëri duhet të shohim modelin shqiptar. Një mandat prej 4 vitesh ndoshta nuk mjafton për të sjellë ndryshim, kur kërkesat për ndryshime janë të mëdha. Eksperiencia është e domosdoshme për të hyrë sa më shpejt “në linjë”. Po të llogaritim këtu edhe faktin që ndryshimi i kreut të bashkisë shoqërohet me


ndryshimin e të gjithë stafit të administratës, që nga nënkryetari deri tek pastrueset, problemi ndërlikohet. Është luks i tepërt që në çdo 4 vjet të trajnosh dhe të përgatitësh nga e para një administratë të tërë. Me këtë logjikë, një mandat është pak, por edhe dy apo tre mandate nuk janë shumë.

Kufizimi i mandateve ka dhe pasoja të tjera negative. Një kryetar bashkie që e di ku e ka kufirin e të drejtës për t’u zgjedhur, nuk është i interesuar dhe i motivuar për performancë maksimale, do të lërë pas dore detyrat e tij dhe mund të shtohet prirja për abuzim me detyrën. Në fund të fundit s’do të jetë i interesuar për votën e qytetarëve.

Do të ishte mirë që të kishte një matës dhe vlerësues të saktë të performancës së të zgjedhurve lokalë. Kështu në vend që të kufizohen mandatet pa përjashtim, e drejta për t’u zgjedhur të mos preket, por seleksionimi të bëhet me votë: kush e meriton, të vazhdojë të qëndrojë edhe 4 mandate, kush s’e meriton, ndoshta t’i ndërpritet edhe mandati i parë, nëpërmjet mekanizmave ligjorë. Por përderisa matës dhe vlerësues të tillë nuk i kemi, derisa diferencimi midis atyre që punojnë mirë dhe atyre që janë një zgjedhje aksidentale e pamerituar nuk funksionon, s’mbetet rrugë tjetër veç kufizimit të mandatit. Kjo është zgjedhje e të keqes më të

vogël, për t’i hapur rrugë procesit normal të rotacionit. Që kjo e keqe e vogël të ketë pasoja sa më minimale, kufizimi i mandateve duhet të jetë për një afat të përcaktuar, të përfshirë brenda periudhës së tranzicionit. Është diçka që të kujton moratoriumin për skafet.

Nëse e gjykojmë këtë kufizim si pjesë të tranzicionit, jemi më të pranueshëm edhe para syve të ndërkombëtarëve, sepse kufizimi i të drejtës për t’u zgjedhur shkon në drejtim të kundërt me procesin e demokratizimit. Pra një kufizim mandatesh për një afat të caktuar, aq sa shihet e arsyeshme që gjendja të ndryshojë: deri kur i zgjedhuri të mos jetë i plotfuqishëm, kur vota e qytetarit të ketë realisht vlerë, derisa të marrë fund arroganca e të zgjedhurve dhe abuzimi me pushtetin.



ZGJIMI I ZHURMESHMËM I KËSHILLIT BASHKIAK

D. LEKA

Mbledhja e radhës e këshillit bashkiak, u zhvillua në datën 02. 05. 2012. Vlen për t'u përmendur pjesëmarrja nga administratra e bashkisë, sepse do të ilustronjë më poshtë edhe rolin e tyre në këtë mbledhje. Ndërkohë, natyrisht që në radhët e këshilltarëve kishte përsëri karrige bosh dhe kartona në prehe.

Pasi u konstatua prezenca mbi 50% nga ana e kryetarit të këshillit, u kalua menjëherë te votimi i rendit të ditës me çështjet si më poshtë vijon:

1-Vendimi për dhënien e ndihmës ekonomike.

2-Miratimi i strukturës së Bashkisë Pogradec, ndërmarrjeve dhe institucioneve në funksion të saj.

3-Pretendimet e UK, Pogradec.

Paçka se u ndje mungesa e replikave dhe argumentave faktikë nga ana e kryetarit të bashkisë, i cili nuk ishte i pranishëm, përsëri atmosfera e mbledhjes së datës 02. 05. 2012 pasoi në një natyrë diversive diskutimesh, ndoshta deri në shfaqjen e notave agresive mes aktorëve pjesëmarrës.

Për çështjen e dhënies së ndihmës ekonomike, u demaskua nga vetë të pranishmit, fakti i mungesës së paarsyetuar të këshilltarëve, duke çuar në dështimin e mbledhjes së komisionit, ndodhi kjo, jo e re tashmë, për të cilën kryetari i këshillit bashkiak u shpreh me nota urdhëruese për të rritur përgjegjësinë e anëtarëve të komisioneve, në funksion të këshillit bashkiak, të cilët nuk duhet të neglizhojnë me angazhimet e marra.

Por një pjesë e rëndësishme e diskutimeve iu kushtua edhe

miratimit të strukturës së bashkisë, ndërmarrjeve dhe institucioneve në funksion të saj. Komisioni i ligjeve për këtë pikë u shpreh se 'nga aspekti formal është në rregull, por lipsen korrigjime në aspektin përmbajtësor'. Pyetjes se 'Këto institucione do të kenë grupe pune apo specialistë?' – administratori u përgjigj se 'procesi i planifikimit është dinamik dhe ne do të ndjekim nevojat që do të rrjedhin gjatë udhës'.

Këshilltari Guri Ademaj pyeti nëse do të përfshihej edhe sektori i mbrojtjes së mjedisit në këtë 'planifikim' dhe administratori

udhëzimet e nxjerra së fundmi nga legjislativi, çojnë në domosdoshmërinë e riorganizimit të strukturës së vjetër, e cila nuk iu përshtatet ndryshimeve ligjore, aktuale.

A do të ndikojë ky ndryshim i strukturës së bashkisë, në pagat dhe shpërblimet e punonjësve? – ishte pyetja e fundit e diskutimit, nga interesi i shfaqur i këshilltares Alketa Darova, por edhe këtu u dha një përgjigje se perspektiva e planifikimit të ri është progresiste në raport me pagat, megjithëse për momentin nuk do të ketë ndryshime të kësaj natyre.



sqaron se 'jo vetëm që struktura e organizuar në këtë formë do të ngushtojë hallkat e miratimit duke shmangur burokracitë, por bashkia do të emërojë një person në krye të këtij sektori, person i cili do të shkurtojë procesin dhe do të rritë efikasitetin, duke i ndjekur personalisht të gjitha procedurat e nevojshme, nisur nga pajisja me të dhënat e duhura, kërkesat formale, deri te dorëzimi praktik në plan të institucionit të ngritur nga ky planifikim'.

Ishte kjo përgjigje që nxiti këshilltarin Avdullah Cane të ngrejë me të drejtë pyetjen: 'Përse po ndodh pikërisht tani risaktësimi i strukturës së bashkisë në një të re?' Edhe për këtë dilemë administratori sqaroi se aktet e reja ligjore dhe nënligjore, si dhe

ketë në qytet dhe çfarë mase është ndërmarrë për personat abuzues?

-Kush kanë qenë më të rregullt në pagesën e faturimeve, individët apo institucionet?

Për të gjitha këto pyetje, nga pala e ujësjellës kanalizimeve, drejtori Ilir Mimini sqaroi se mund t'iu përgjigjet detajisht secilës, por një lexim më i detajuar i materialit nga ana e këshilltarëve do të kishte sheshuar çdo enigmë apo dyshim, që mesa duket rrjedh nga moskuptimi i materialit apo neglizhimi i tij. Më pas vijoi me përgjigjet e çdo pyetjeje si mëposhtë:

-Tarifat dhe faturat miratohen nga këshilli mbikqyrës.

-Tarifa e konsumatorëve familjarë në krahasim me institucionet, po shkon në logjikën e barazimit të çmimeve.

-Kthimi në urdhër ekzekutiv e ka thjeshtësuar punën e penalizimit të shkelësve, duke çuar deri në konfiskime mjeteshe në pamundësi të pagesave.

-Çdo rast i zbulimit të lidhjeve të fshehta është denoncuar në prokurori dhe ende interesohemi për rastet e pazbuluara.

Natyrisht u mundam që t'i përmbledhim këto pyetje-përgjigje, ashtu siç propozoi edhe kryetari i këshillit z. Eduard Kapri, pasi para se të vijë tek një linjë komunikimi i drejtpërdrejtë sqarimi, diskutimet u nxehën edhe mes këshilltarëve, me çështje si:

-Përse duhet të paguajë qyteti faturimet e fshatit?

-Përse duhet të vijë puna deri te rritja e çmimit, kur momentalisht jemi në një situatë të mjerueshme papunësie dhe varfërie?

Madje nuk munguan edhe sugjerimet kompetente nga ana e

Çështja më kulminante e diskutimit erdhi tek votimi i rritjes së çmimit nga UK-ja për qytetarët. Këshilltarët, pasi (supozohet) kishin shfletuar materialet, ngritën një mori diskutimesh të flakta mbi pika të rëndësishme të materialit të paraqitur nga ana e UK-së Pogradec. Ndër pyetjet më të debatueshme ishin:

-Cila është mesatarja e përqindjes së humbjeve të deklaruar?

-Kush i cakton tarifat dhe faturat?

-Pse dhe si është ndryshuar tarifa e konsumatorëve familjarë në krahasim me institucionet?

-A ka pasur ndonjë ndjekje penale për debitorët dhe në rast se po, cila është kjo përqindje?

-Sa lidhje të fshehta mund të

Intervistë me drejtorin e ndërmarrjes sh.a. UK, z. Ilir Mimini

Zoti Mimini, cili është historiku i projektit dhe zhvillimi i tij?

Projekti mjedisor i liqenit të Ohrit është një projekt shumë i rëndësishëm, që në përbërjen e tij ka dy komponentë kryesorë për dy shërbime shumë të ndjeshme në dobi të qytetarit, siç është furnizimi me ujë të pijshëm në sasi dhe cilësi të garantuara, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.

Ky projekt ka filluar fillimisht me komponentin dhe ndërtimin e sistemit të ri dhe furnizimit me ujë të pijshëm, i cili ka filluar të zbatohet në vitin 2005 dhe ka pasur si komponent kryesor ndërtimin e një stacioni të ri pompimi, me standarde bashkëkohore. Ndërtimin e transmetuesit të ri prej 6 km nga stacioni i pompimit, ndërtimi i rezervuarve të rinj dhe rehabilitimin e atyre ekzistuese. Ndërtimi i rreth 8 km rrjet të brendshëm dhe vendosjes së matësave sipas standardeve bashkëkohore.

Kjo, në totalin e atyre që janë realizuar dhe të atyre që pritet të realizohet, duke arritur vlerën e 12.5 milion eurosh vetëm për komponentin e ujit të pijshëm. Menjëherë mbas këtij komponenti, siç ishte rënë dakort, filloi përgatitja e fazave për zgjidhjen e problemit të grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të përdorura.

Drejtor, cila është ecuria e këtyre fazave dhe a mund të na bëni të ditur kostot e secilës fazë?

Natyrisht, faza e parë prej 9.5 milion eurosh, konsistonte në ndërtimin e disa strukturave të tjera dhe ndërtimin e kolektorit kryesor përgjatë shëtitorës "10 Dëshmorët e Pojskës" me gjatësi 2 km. Ishin tre faza ndërhyrëse dhe rehabilitimi në përroin e qytetit.

Theksoj ndërtimin e stacionit të pompimit në stacionin e 1 Majit. Tubin e presionit prej 3.5 km, që shkon nga stacionin i pompimit në impiantin e pastrimit. Impianti i pastrimit në vetvete gjatë vijës është një vepër gjigante, ku përfshihet dhe fshati Tushemisht, me ndërtimin e rrjetit të brendshëm të këtij fshati. Kjo logjikë u ndoq me Pogradecin dhe Tushemishtin, duke

qenë dy zona bregliqenore, ku nevoja ishte më e lartë dhe më emergjente. Në vazhdim të kësaj faze, ishte një investim prej 1.5 milion euro bashkëfinancimi nga qeveria shqiptare.

Në fazën e dytë, e cila konsistoi në 6.5 milion euro për ndërtimin e 70 km rrjet të brendshëm në qytet dhe lidhje banesash për ujrën e përdoruar. 1.5 milion euro ishte bashkëfinancimi i qeverisë shqiptare, ndërsa pjesa tjetër ishte një grant i qeverisë gjermane, nëpërmjet bankës KFW. Në këtë projekt u mbyll pjesa më e populluar e qytetit të Pogradecit.

Në fazën e tretë, ishte parashikuar përmbyllja tërësore me sukses e projektit të ujit të pijshëm dhe atyre të ndotura për të gjithë fshatrat e këtij pellgu. Në këto momente që po flasim, po përmbillet faza e dizenjimit dhe tani fillon përgatitja e dokumenteve të tenderit, plotësimin tërësor të qytetit për gjithçka që thamë më lart. Në këtë fazë parashikohet dhe trajtimi i ujërave të lumit të Vërdovës, ku përfshihet edhe fshati në fjalë. Gjithashtu, kjo fazë parashikon edhe shtrirjen e tubacioneve të ujit të pijshëm dhe vendosjen e matësave për fshatrat Vërdovë, Rrëmenjë dhe Gurras. Ndërtimin e një stacioni të ri për ujin e pijshëm në Gurras dhe një transmetuesi të ri prej 6 km për fshatin Gështenjës, në fakt ka dyfishim të kapacitetit, pasi impianti është për 25 000 banorë dhe do të dyfishohet për 50 000 banorë. Duke qenë se kemi probleme me përrenjtë që përmbledhin ujrën e ndotura dhe me fosforin që ndikon keq në zhvillimin e algës së gjelbër, është rënë dakort që të futet dhe



pastrimi kimik, i cili është shumë i kushtueshëm. Kostoja e këtij projekti është 13.5 milion euro, nga të cilat 10 milion euro janë kredi e butë, marrë nëpërmjet bankës KFW dhe 3.5 milion është grant i BE-së, nëpërmjet projektit që ata kanë. Një nga kondicionet kryesore të dhëna nga donatorët, ishte dhe është ulja e humbjeve në ujin e pijshëm dhe rritjen e vlerës së arkëtimit, ulja e numrit të punonjësve të kësaj ndërmarrjeje, me arsye për të mbuluar koston e amortizimit. Në këto kondicione, është bërë një analizë shumë e detajuar dhe ka dalë e domosdoshme që për drejtim të shitjes së ujit të pijshëm dhe largim të ujërave të përdoruar, të rrisim dhe tarifën e koston të shitjes. Brenda kësaj llogjike është aplikuar që në vitin 2005 rritja graduale e tarifës së ujit 57 lek/m³. Që nga ai vit, ne kemi aplikuar 4 herë për rritjen e tarifës, edhe nga ana e Entit Rregullator të Ujit (ERU), i cili ka për detyrë të mbrojë interesat e qytetarit.

Në të katër rastet, aplikimet kanë dalë të suksesshme, duke filluar nga 2005 që ishte 30 lek/m³ dhe ka arritur sot në 55 lek/m³. Në bazë të kësaj logjike dhe në përputhje me kontratën e nënshkruar me KFW deri në vitin 2012, duhet të arrijmë në çmimin 63 lek/m³. Për këtë arsye në kemi filluar aplikimin për të marrë statusin pilot për zbatimin e metodologjisë që ERU-ja, në bazë të legjislacionit shqiptar,

vijon në faqen tjetër



Intervista

Intervistë me drejtorin e ndërmarrjes sh.a UK, z. Ilir Mimini

vijon nga faqja tjetër

po zbaton në lidhje me objektivin e tjetërsimit të tarifave. Në bazë të legjislacionit, fillimisht kalohet me një kërkesë, e cila i drejtohet këshillit të komunës dhe atij të bashkisë, ku i kërkohet të shprehet për këtë ndryshim të tarifës së ujit. Nga ana e tyre, këshillat komunalë dhe bashkiakë, duke qenë se janë edhe ata mbrojtës së interesave të komunitetit të tyre, shprehen pozitivisht ose negativisht mbi pretendimet tona (paçka se kanë përfaqësitë e tyre me të drejtë vote në këshillin mbikqyrës), por këshilli bashkiak nuk mund të kontribuojë më shumë se me pëlqimin ose jo të tij, pasi është ERE ajo që jep verdiktin përfundimtar.

A ishte në dijeni këshilli mbikqyrës për problematikat e shtruar në mbledhjen e këshillit bashkiak të datës 02.05.2012, mos ndoshta duhet të kishte një komunikim paraprak mes tyre, për të mos konverguar në konfrontime idesh dhe propozimesh?

Më lejoni t'ju sqaroj përbërjen e këshillit mbikqyrës, rolin dhe funksionin e tij në lidhje me ndërmarrjen tonë. Këshilli mbikqyrës përbëhet nga gjashtë anëtarë, të cilët në bazë të aksioneve që disponojnë (katër prej tyre janë zgjedhur nga këshilli bashkiak, si aksioner kryesor dhe dy nga këshilli komunal Buçimas, si aksionere dytësore). Për sa i përket konfrontimeve gjatë mbledhjes që ju monitoruat, këshilli mbikqyrës ka qenë i ftuar të bëjë analizën e punës brenda Drejtorisë së Shërbimit të UK, ku bëhet një analizë shumë e hollësishme dhe e detajuar. Në analizën e zhvilluar në datën 4 prill pranë UK- Pogradec, dolën në përfundimin që është një nga ujësjellësat me rendiment të konsiderueshem. Kjo analizë është bërë edhe pranë këshillit mbikqyrës, por procedura ligjore, aq sa di unë, nuk kërkon që këshilli mbikqyrës të informojë këshillin e bashkisë, megjithëse është një mungesë e kërkesës nga ana e këshillit të bashkisë, duke qenë edhe aksioner i

drejtpërdrejtë dhe i rëndësishëm i drejtorisë sh.a UK, që të kërkojë sqarime.

Ju e patë që këshillit bashkiak i nevojitej një seancë pushimi për t'i riargumentuar propozimet, nëse këshilli do të informohet më në imtësi dhe do t'iu rikërkojë për sqarime të mëtejshme, do të paraqiteshit sërish?

Unë asnjëherë nuk ngurroj për të dhënë shpjegime, por për mendimin tim, ato që ndodhën në mbledhjen e kaluar ishin zhvillime të panevojshme, pasi ligji thotë qartë që 'këshilli bashkiak duhet të shprehet pozitivisht ose negativisht, por të drejtën e votës e realizon nëpërmjet përfaqësuesëve në këshillin mbikqyrës'. E mira do të ishte që ata ta kishin kuptuar procedurën dhe të ishin shprehur pozitivisht, por ata kanë lënë që kjo të studiohet nëpërmjet këshillit mbikqyrës, duke lënë një opsion të hapur edhe me një informim të mëvonshëm, mbasi ne na duhet mepatjetër një opinion pozitiv ose negativ.

Zoti drejtor, nëqoftëse gjithçka shkon sipas planifikimit tuaj, kur mendoni se qytetarët do të shohin fillimin e fazës së tretë dhe të fundit të projektit në fjalë?

Ne presim që të nisim tani së shpejti me fazeën e tenderimit dhe fillimin e projektit, i cili do të nisë muajin dhjetor të këtij viti dhe mendohet që të përfundojë mbas 18 muajsh me sistemimin dhe rehabilitimin e të gjithë zonës në fjalë.

Ju falenderojmë për intervistën dhe gatishmërinë tuaj, duke ju vemë në dijeni se numrin tjetër të buletinit tonë, do të ketë një intervistë nga një anëtar i këshillit mbikqyrës për këtë temë.

-Punë të mbarë!

INTERVISTUAN:

L. KARAJ

M. VRETO

L. ZEQQOLLARI

D. LEKA

ZGJIMI I ZHURMESHMËM I KËSHILLIT BASHKIAK

vijon nga faqja 9

punës së UK-së Pogradec!

-Të ndryshojë organizimi dhe të përmirësohet struktura e UK-së!

Por nga ana tjetër e arenës së debatit vëreheshin edhe konstatime përgëzuese për UK-në nga këshilltarë të tjerë, me citate si:

UK-ja duhet përgëzuar për punën e deritanishme; Simotrat e kësaj ndërmarrjeje në rajon janë në një nivel më të ulët funksionimi dhe procedimi; Nuk është kompetenca jonë të propozojmë ndryshime në strukturën dhe organizimin e punës së UK-së; etj.

Siç mund të lexohet edhe më sipër, konfrontimet e këtyre ideve pasuan me nota të ashpra komunikimi mes këshilltarëve dhe deri te drejtori i UK-së. Megjithatë, meqënëse tejzgjatja e diskutimit të kësaj çështjeje (si gjithmonë) po konsumonte angazhimet e jashtme të ndonjë këshilltari, filluan të valviteshin tek-tuk kartonat e gatshëm për votim. Ndërkohë, që u propozua një pushim për të përmbledhur argumentet dhe riformuluar idetë mbi materialin e paraqitur nga UK-ja, në mënyrë që të reflektohej sa më bindshëm nëpërmjet votimit të këshillit bashkiak, u propozua një pushim i domosdoshëm.

Pas pesë minutash, që ngjasonin me tepër me një grupim ku këshilltarët bënin dakortimet e votimit, se sa sqaronin pikat e paqarta të materialit, që vetëm nga pyetjet dhe propozimet e tyre të mëparshme tregojnë që ishin të shumta, u kalua në votim. Nëntë këshilltarë ishin 'Pro', kurse trembëdhjetë prej tyre 'Kundër'. Duhet thënë që një këshilltar u largua gjatë pushimit, pas tij edhe përfaqësuesit e UK, Pogradec.

Ka një dilemë vërtetë të madhe që këshilltari Guri Ademaj e tha para se të votohej:

-Nëse Këshillit Bashkiak i kërkohet të shprehet vetëm me një opinion pozitiv (pëlqim) apo opinion negativ (mospëlqim) dhe nuk ka të drejtë vote, atëherë në i bie të votojmë mendimet tona dhe jo vendimet.

Sqarimet e metejshme për këtë pikë, do t'i servirin nga intervista që i bëmë drejtorit të UK-së, Pogradec, z. Ilir Mimini, duke paraqitur në numrin e ardhshëm edhe intervistën e një këshilltari anëtar të këshillit mbikqyrës.

Quiz

Ky pyetësor synon të testojë informimin e qytetarëve për përfaqësuesit e saj në Këshillin Bashkiak, Pogradec

Plotësoni kuadratet bosh me të dhënat që mungojnë!



PARTIA SOCIALISTE

- 1. Sotiraq []
- 2. [] Katiraj
- 3. [] Dervishi
- 4. Syrja []
- 5. [] Maxhari
- 6. Natalja []
- 7. [] []
- 8. Guri Ademaj



LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM

- 13. [] Hyka
- 14. [] F. Gusho
- 15. [] Hoxha



PSV 91

PARTIA [] []

20. Petro Stefani

21. Thoma []

PARTIA DEMOKRISTIANE

22. [] Mema

PARTIA SOCIAL DEMOKRATE

- 16. Eduard []
- 17. [] Rapçe

LDK

23. Ilir []



PARTIA DEMOKRATIKE

- 9. Hasan []
- 10. [] Jajçari
- 11. [] Berberi
- 12. Sandri []

PARTIA REPUBLIKANE

- 18. Avdulla []
- 19. Evelina []

PDIU

24. [] Hamollari

ADSL

25. [] Shuli

Personi i cili paraqet pyetësorin e plotësuar në mënyrë korrekte shpërblehet me një dhuratë modeste nga grupi ynë i monitorimit. Dorëzimi i pyetësorit bëhet tek zyra e shoqatës “Unë, Gruaja”. tel: 083222140

“Publikimi i këtij materiali mbështetet financiarisht nga Zyra e Çështjeve Publike e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë. Mendimet dhe opinionet e shprehura nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Departamentit Amerikan të Shtetit”

Bota Lasgushiane, Atdheu, Dashuria, Natyra

Shkruar nga: **Budjon XHELO**



Që nga Homeri i madh e deri më sot, tri janë temat e mëdha të letërsisë së madhe botërore: atdheu, dashuria, natyra-të cilat poeti ynë Lasgush Poradeci i përmendte shpeshherë në bisadat e tij.

Të gjithë ne jemi të gëzuar që ndodhemi në këtë ditë dimërore në Pogradec në qytetin e dy magjistarëve të gjuhës shqipe; e poetit të madh Lasgush Poradeci dhe poetit të prozës Mitrush Kuteli. Poezia e Lasgushit e shkruar në kohë të errëta ngaherë më kujton atë vargun aromatik dhe farfuritës të këngës popullore “Manushaqe e Prillit në mes të Dëborës”. Lasgushi i dhuroi poezisë shqipe një grusht me lirika të xhevahirta, pa të cilat, me siguri ajo do të ndihej e mangët. Ato u krijuan nga muza e tij poetike prej një talenti të posaçëm dhe prej ndërgjegjes së tij artistike. Thonë se krijoi pak, por kjo s’është e vërtetë.

Ai krijoi aq sa i duhej një artisti për të qenë zë më vete, stilist i pangatërrueshëm dhe letërsi poetike e një kohe që vështrohet prej të gjithë koordinatave të kohrave që vijnë.

Bota objektive dhe bota subjektive u shkruan në një letërsi të vetme dhe krijuan një botë artistike të emërtuar atë që ë quajnë botë lasgushiane. Bota lasgushiane është një botë e plotësuar pavarësisht nga madhësia e saj, por bota si botë, ka beharin ka dhe dimrin e saj.

Lasgushin, shkrimtari ynë i madh Ismail Kadare e ka quajtur nosit i poezisë shqipe dhe është një cilësim dhe epitot shumë i bukur dhe përcaktues për këtë poet. Poeti ynë Lasgush e përballoi atë masë kohe që duhet si gur prove për të mbetur në tempull të artit, kultin e këtij arti. Këtë tempull ai e përjetoi gjatë gjithë jetës së vet. E vërteta se koha i ktheu dhe po kthen shumë gjëra të cilat më parë

kritika në stadin e saj edhe foshnjor ia kishte mohuar dhe është më mirë kështu kur t’i kthejnë borxhet sesa kur ke për të kthyer borxhe. Arti emocionon. Ja një mësim që na jep ne të gjithë brezave poezia e Lasgush Poradecit. Poeti nxjerr në dritë të diellit dhe bën me gojë ndjenjat më të thella, më të fshehta të shpirtit njerëzor. Ai është një eksplorator i thellësive të shpirtit të njeriut dhe i bërthamave dramatike ku ndeshen dritëhije dhe çlirohen energji njerëzore.

Këtë karakter dramatik të poezisë së tij e ka vënë re që në 1929 profesori i shquar Eqerem Çabej.

Ndjeshmëria e lartë derdhet në forma të brishta dhe të tejdukshme.

Të gjithë jemi ndodhur në çaste vetmie dhe përumbjeje. Patjetër, s’ka sesi të mos të të kujtohet dhe vargu i Lasgushit që e derdhi si në bronx këtë moment.

“Futet zemra djaloshare mu në fund të shpirtit tim”

Çfarë abstragimi dhe çfarë fantazie e ndezur poetike. Pa to nuk ka art madhor. Poezitë filozofike të peisazhit dhe të dashurisë të poetit Lasgush Poradeci janë poezi të dinjitetit njerëzor. Është e vërtetë që atij më fort se jeta i intereson ëndrra, pra jeta e përsosur. Disi mbikohore, mbarëkohore, i intereson një planetorizëm idesh, ndjenjash, vizionesh.

Kur distancohet nga jeta edhe magma e tij poetike ftohet, mbështillet me mjegulla, kur afrohet me të dhe këtu është pikërisht forca e tij, atëherë dhe arti poetik lasgushian ka freskinë e burimeve malore ose ngrohtësinë e ujërave termalë të tokës.

Ndoshta një nga këto rivlerësime të poezisë të Lasgushit, të cilat kritika dikur ja kishte mohuar do

ishte, nëse ajo është poezi sociale apo nuk është poezi sociale. Sigurisht ka patur ekstrimitete në të, por e vërteta është që kjo është një poezi sociale e tërthortë. Nuk është e karakterit të drejtpërsëdrejtë të Migjenit, por po të mungonte ajo do t’i mungonte një nga pemët e bukura kopshtit poetik shqiptar.

Me Lasgushin gjuha artistike e papërdhunë, në qoftë se shprehemi me një fjalë të tij, u përkrye, arriti një pastërti, një muzikë, një përqëndrim ndjenje dhe mendimi. Ai na mësoi se poezia është arti i kuptimit të fjalëve, por edhe i magjisë tingullore të tyre, i pasurisë së ritmeve dhe i figurave brilante.

Lasgushi ishte i dashurur me këtë tokë, me këto këngë, më këtë liqen, me këtë gjuhë kaq të fuqishme, por edhe kaq të ëmbël si prej mjalti. Po të kërkonim një metaforë të jetës dhe të veprës së Lasgushit, unë do thoja që ajo që e përfaqëson atë kudo është liqeni i Poradecit, të cilit ai i këndoi me aq zjarr dhe aq bukur. Liqeni ishte shoku i tij, ishte sozia e tij, vetja e tij e dytë. Diku ai thotë:

“Si shpirt i zi në kraharuar u mbyll liqeri nënë male”

Arti pëmbi liqen,

Liqeni pëshpërit emrin e poetit,

Dhe nxjerr nga gjiri si një nosit,

që lajmëron mëngjesin, vargun e tij,

këngën e tij të pavdekshme

POETI BËN ATDHE, funksionarët kalojnë, - i ka thënë poeti një funksionari të lartë partie në vitin 1981. Pjetër Budi, Pjetër Bogdani, Naim Frashëri, Andon Zako Çajupi, Ndre Mjeda, Gjergj Fishta, Fan Noli, Migjeni, Asdreni, Lasgushi, Dritëro Agolli dhe Ismail Kadare etj. Është kolana e poetëve që bëjnë atdhe.

Qyteti i Pogradecit ka privilegjin t’i ngjajë qytetit gjerman Vajmar që ka nxjerrë Gëten dhe Shilerin.



Anoreksia Kronike me Origjinë Nervore parandalimi është prioritar që askush të mos e pësojë nga kjo sëmundje.

*Dr. Andrea Kocaqi**

Anoreksia kronike

Me anoreksi kronike do të kuptojmë humbjen në mënyrë kronike të dëshirës për të ngrënë. E theksoj në mënyrë kronike pasi të gjithëve mund të na ketë ndodhur humbja e oreksit në mënyrë akute, (të shpejtë), kur kemi kaluar një sëmundje po akute si; gripi, angina, bronkiti, diarea etj. Por pas kalimit të këtyre sëmundjeve edhe oreksi rikthehet. Anoreksia kronike ka disa shkaqe, por për arsye se përqindja e tyre është shumë e vogël, në këtë artikull do të shtjelloj anoreksinë kronike me origjinë nervore, (AKN). Kjo lloj anoreksie ka qenë e njohur qysh nga thellësia e shekujve, por i pari që bëri një përshkrim të saktë ishte Louis V. Marce në vitin 1860, më pas ishte merita e Charles Lasegue dhe William Gull që hodhën bazat për një nozologji më vete.

Incidenca e kësaj sëmundjeje shkon deri në 0.5% të popullsisë ku 90% e tyre janë femra, por problem shqetësues është se në dekadat e fundit në mënyrë të frikshme po shtohen rastet në radhët e adoleshentëve.



Edhe nga vetë emërtimi kuptohet se zanafilla e kësaj sëmundjeje është psikologjike, kryesisht me akses social dhe familjar. Në aspektin social mund të përmendim; tipa të mbyllur, dhuna fizike, emocionale e seksuale, (jashtë familjes), frika opsive për të mos u shëndoshur, mania për të patur një trup sa më “elegant”, femra të përfshira në industrinë e modës, zhgënjimet afektive, problemet madhore në çift

sidomos divorcet e tij. Në aspektin familjar do të përmend; familje ku mungon komunikimi i mirë ndërpersonal ku babai mund të jetë pianec apo nëna me sëmundje psikike, familje ku ushtrohet sistematikisht dhunë fizike, emocionale e mbi të gjitha seksuale, familje me gjendje ekonomike të dobët etj. Fëmijët në këto raste e zhvillojnë AKN si formë proteste, revolte apo për të tërhequr vëmendjen për gjendjen aktuale.

Sëmundja fillon me

uljen drastike të sasisë së ushqimit ditor, më pas me eliminimin e disa ushqimeve që sipas tyre të shëndoshin dhe më në fund vjen humbja e shijes dhe neveria për të ngrënë. Me t'u instaluar sëmundja do të shfaqen simptomat dhe pasoja e saja. Simptomat dhe pasojat e ANK janë shumë karakterisike e të larmishme dhe të gjitha janë të lidhura me kequshqyerjen e pacientit. Disa prej tyre që hasen më shpesh janë:

Pesha trupore nën minimumin e lejueshëm.

Dhimbje koke gati e vazhdueshme, ndihet apatik, mos përqëndrim, stres, ankth, depresion apo çregullime të tjera opsive. Lëkurë të thatë e plot akne, thonj e flokë të hollë e të thyeshëm. Mungesë e periodave dhe e dëshirës seksuale. Ulje e prodhimit të lëngut të stomakut që pasohet me gastrit, ulcer apo pnkreatit kronik. Ulje të sheqerit në gjak që shfaqet me ndjenjën e lodhjes së përherëshme. Ulje të përqëndrimit të kalciumit në koska që shfaqet me dhimbje të tyre e që pasohet me osteoporozë e karies dentar. Pezmatim të këndeve të buzëve dhe gingivit kronik që tregon për anemi. Shtim të kortisolit që shpërthen sindromin Cushing. Ulje të ruazave të bardha në gjak që tregon për një imunitet të dobët dhe për mundësinë e shpërthimit të sëmundjeve të tjera akute apo kronike. Dhe së fundi stopim të rritjes normale dhe të inteligjencës.

Trajtimi i pacientit me ANK ndahet në medikamentoz, psikoterapi dhe parandalim.

Trajtimi medikamentoz konsiston në marien e 1500 –

1800 k.kalori në ditë me një shumëllojshmëri ushqimesh, por synohet në karbohidrate dhe yndyrna. Vitaminoterapia synon në marrjen e vitaminave B_{kompleks}, C, PP, A dhe D₂ shoqëruar me kalcium glukonat apo tiosulfat në muskul ose në venë. Mund të aplikohen steranabolizante që kanë veprim të fortë metabolik, por të ulët androgjen. Gjithashtu dhe prednisolon ose deksametazon. Nëse kemi dhe çregullime të sferës psikike mund të japim rispëridonin, olanzapinën, amitriptilinën etj. Ajo ç'ka do të ishte më e efetshme në këto raste do të ishte psikoterapia dhe klimoterapia, (sidomos ajo malore), e aplikuar nga një profesionist i kësaj fushe.

Gjithësesi parandalimi është prioritar që askush të mos e pësojë nga kjo sëmundje me shumë vektorë. Për parandalimin e ANK lipset që në marrëdhëniet në familje të jeni të hapur e të sinqertë, ndërtoni një komunikim të mirë me fëmijët tuaj duke shmangur të bërtiturat dhe urdhërat pasi asnjëherë nuk mund të parashikosh reagimin e adoleshentit. Bëni çdo mundësi për të mos rënë pre e alkolit pasi ju bën karagjozë në sy të familjes e shoqërisë, e një adoleshent nuk e toleron dot një gjë të tillë. E gjithë shoqëria duhet të ngrejë zërin e t'i thotë “STOP” dhunës në përgjithësi e asaj në familje në veçanti. Nga ana tjetër i gjithë personeli arsimor dhe ai i mjekësisë së familjes duhet të zhvillojë biseda me adoleshentët për një shëndet sa më të qëndrueshëm. Së fundi të gjitha ato femra që merren me industrinë e modës, përpara se të aplikojnë dieta apo regjime dietetike, të konsultohen detyrimisht me një profesionist.



Kërkesë

Kërkuese:

Luljeta Sadikaj, e bija e Ademit dhe Hysnies, e datëlindjes 10.08.1963, lindur ne Pogradec dhe banuese në Tiranë, në adresen rruga e Durrësit, ish shkolla e Partisë, godina nr.2, apartamenti 54.

Objekti:

Shpallja e zhdukjes dhe vdekjes se Luan Sadikaj.

Baza Ligjore:

Neni 15 e vijues I Kodit Civil. Neni nr.53 e vijues i Ligjit nr.10129 date 11.05.2009 "Per Gjendjen Civile"

Përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë

Unë kërkuesja Luljeta Sadikaj, ju drejtova kësaj Gjykate për te kërkuar shpalljen e zhdukjes dhe vdekjes se Luan Sadikaj.

Luan Sadikaj është xhaxhai im.

Në vitin 19.07.1949, Luan Sadikaj, I datelindjes 20.03.1929, I lindur ne Starovë-Pogradec, është aratisur ne Jugosllavi, fakt I vërtetuar

nga Vendimi nr.125/1, date 30.02.2011, lëshuar nga Drejtoria e Arkivit, Ministria e Brëndshme.

Që nga koha kur Luan Sadikaj, është arratisur e deri më sot ne nuk kemi marre asnjë lajm nga ai.

Për te ne familja e tij nuk dimë se c'fare behët, qe nga koha kur ai është larguar nga familja e tij rreth moshës 19 vjec.

Duke patur parasysh se xhaxhain e kemi ne trungun e familjes, vërtetuar nga Certifikata e trungut familjar te lëshuar nga Qarku Korçë, Komuna Bucimas, nxjerrë na regjistri themeltar Bucimas, nr.5/18, viti 1974, datë11.03.2011, kërkojmë që të bëjmë c'regjistrimin në Zyrat e Gjëndjes Civile.

Për këtë arsye referuar nenit 15 vijues të Kodit Civil I kerkoj Gjykatës që të shpallë të zhdukur dhe të vdekur Luan Sadikaj.

Bashkangjitur ju vemë ne dispozicion edhe dokumentet shkresore te nevojshme.

Tiranë, më 02.05.2011

Me Respekt

Luljeta Sadikaj

Njoftim punësimi

Në kuadër të projektit " **Fuqizimi ekonomik i gruas në zonat turistike nëpërmjet prodhimeve të punës me dorës**", Shoqata e Grave me Probleme Sociale, për implementimin e këtij projekti kërkon të punësojë një asistente projekti, përkatësisht në zonën e Tushemisht/Pogradec.

Njohuritë dhe eksperiencia

- Diplome universitare, preferohet në histori -filologji, shkencat sociale, ekonomia biznes, etj
- Eksperiencia të mëparshme në zbatimin e projekteve në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të grave
- Eksperiencia të mëparshme në zbatimin e projekteve në fushën e turizmit
- Njohuri të mira të gjuhës angleze
- Eksperiencia të mëparshme dhe aftësi në shkrimin e raporteve të punës
- Aftësi shume të mira koodinuese
- Aftësi komunikimi dhe të punes në grup
- Njohuri shumë të mira kompjuterike në programet MS Office.

Aplikanët e interesuar për punë duhet të paraqesin një kopje të CV dhe një leter interesi në adresën: Gazeta "Nositi", Rruga Rinia Pogradec, ose Shoqata "Une, Gruaja", Rruga Reshit Çollaku, Pogradec brenda datës 27 Prill 2012, ora 17:00

Mund të na kontaktoni në adresën e e-mail-it: shoqatagrave@yahoo.com, ose tel 052 234600

Po në këtë adresë jeni të lutur të dërgoni ofertat për shtëpinë me qera.

Njoftim punësimi

Në kuadër të projektit " **Fuqizimi ekonomik i gruas në zonat turistike nëpërmjet prodhimeve të punës me dorës**", Shoqata e Grave me Probleme Sociale, për implementimin e këtij projekti kërkon të punësojë një koordinatorë lokale, përkatësisht në zonën e Voskopojës /Korçë.

Njohuritë dhe eksperiencia

- Preferohet diplomë universitare në degën: ekonomi biznes, mësuesi, etj.
- Eksperiencia të mëparshme në zbatimin e projekteve në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të grave.
- Eksperiencia të mëparshe me projekte në fushën e turizmit
- Aftësi shumë të mira koordinuese
- Aftësi komunikimi dhe të punës në grup

Kërkohet ambient me qera

Kërkohet një shtëpi, 2 + 1, për ambiente zyre dhe repart pune të traditës, në Tushemisht. Preferohet shtëpi karakteristike e zonës.

Mundësi për të rinjtë! Angazhohu edhe ti!

Në kuadër të Projektit "Ndërgjegjësohu - Monitoro - Vepro"
financuar nga Ambasada Amerikane

Janë të ftuar të aplikojnë vajza dhe djem për të monitoruar Këshillin Bashkiak Pogradec. Qëllimi i këtij projekti është të rrisë ndërgjegjësimin e komunitetit, shoqërisë civile, anëtarëve të këshilit bashkiak dhe medias për t'u bërë pjesëmarrës aktivë në vendimmarrje.

Mund të sillni CV-të tuaja pranë shoqatës "Unë, Gruaja" në adresën Rr. Rreshit Çollaku. Pogradec; ose e-mail: une_gruaja@yahoo.com.

Kontribo edhe ti për qytetin tënd!

Për më shumë informacion kontaktoni në numrin e telefonit 083 222- 140
Jeni të mirëpritur!

Mekanizmi i Referimit Kundër Dhunës - në Veprim

Shoqata "Unë, Gruaja", në kuadër të angazhimeve që ka marrë si anëtare e Komitetit Drejtues të Mekanizmit të Referimit dhe Trajtimit të Rasteve të Dhunës në Familje në Pogradec, do të organizojë 6 (gjashtë) workshop-e në periudhën Maj-Qershor 2012.

Pjesëmarrës në këto workshope do të jenë institucione e aktorë të tjerë, të cilët në bazë të Ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 "Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare" (i ndryshuar) neni 8, pika 8 e tij; si dhe të VKM nr. 334, datë 17.02.2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij", janë pjesë e Mekanizmit Referues në Pogradec:

Zyra për Barazi Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje,

Komisariati i Policisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Prokuroria e Rrethit, Zyra e Përmbarimit, Mjeku Ligjor, Drejtoria e Shëndetit Publik, Qendra Shëndetësore, Drejtoria Arsimore, Zyra e Punësimit, Shoqata "Unë, Gruaja", Dhoma e Avokatisë, etj.

Në këto workshop-e secili institucion do të prezantojë rolin e vet, detyrimet, përgjegjësitë, e angazhimet sikurse janë të përcaktuara në ligj.

Do të diskutohen metoda dhe mundësi praktike të ndërveprimit, duke krijuar një sistem të reagimit të koordinuar, të përshtatshëm në kontekstin e komunitetit tonë, për të ofruar mbështetjen dhe shërbimin efektiv për personat që janë viktimë të dhunës në marrëdhëniet familjare.



Shitje shtëpie

Cel: 0692750617
Cel: 0682072562



Shitet një apartament në Pogradec, 1+1 me dy ballkonë. Banesa ndodhet në qendër të qytetit, me pamje nga liqeni, 100 metra larg bregut të liqenit. Sipërfaqja 55 metra katrore, kati i 7-të (pa ashensor). Shitet bashkë me pajisjet.

Botues: Ilir DUKA & Afroviti GUSHO
Gazetarë: Ilir Buzali, Ketrina Mitllari
Korrespondente: Alda Isallari, Dorian Leka
Lexoni gazetën në: www.poradeci.com
Gazeta shpërndahet në Qarkun Korçë

Enti Botues: "DIJA - Poradeci" -Pogradec
Adresa e Redaksisë: Rruga "Rinia", Pallatet 7-katësh, Pogradec
Tel: +355 832 2905, Mobil: 069 2143753
e-mail: afrovitig@yahoo.com